Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti
Mbledhja nr. 21/2021
Prishtinë, më 5.8.2021, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla 506

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Jeta Statovci, nënkryetare e parë, Fidan Jilta, nënkryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Armend Muja, Driton Hyseni, Gramos Agusholli, Valentina Bunjaku–Rexhepi, Pal Lekaj dhe Ljubinko Karaxhiq, anëtarë.

Munguan: Ferat Shala, kryetar dhe Uran Ismaili, anëtar.

Të ftuar: Jeton Mehmeti, kryesues i Bordit të NPKOSTT Sh.A. dhe Mustafë Hasani, kryeshef ekzekutiv, NPKOSTT Sh.A.

Pjesëmarrës tjerë: Arben Dodaj, Ajrina Gashi, Xhyldane Kiçmari, Nebih Zariqi anëtarë të Bordit, NP ”KOSTT” Sh.A.; Kadri Kadriu dhe Sylejman Nuredini, NP ”KOSTT” Sh.A.; Dardan Berisha dhe Egzona Terdevci– GP- LVV, Bjondina Çanta – Kuvend, Leonora Bajrami - KDI, Edonitë Hebibi – Ekonomia Online, dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi Jeta Statovci, nënkryetare e parë e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 27.7.2021;**
3. **Shqyrtimi i raportit të grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shoqëritë tregtare;**
4. **Raportimi i bordit dhe menaxhmentit të NP ”KOSTT”, lidhur me organizimin e brendshëm dhe zbatimin e projekteve;**
5. **Të ndryshme.**

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja propozoi që në rend dite, te pika 2 (dy) e rendit të ditës, të shtohet miratimi edhe i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur dje, më datë 4.8.2021.

Propozimi u miratua unanimisht.

Armend Muja, propozoi që ne rend dite të shtohet edhe një pikë, si pikë 5 (pesë): "Shqyrtimi i shkresave të Agjencisë Kundër Korrupsionit, lidhur me rastin AKK-DPKI-06-2773/20-Xhyldane Kiçmari dhe AKK-DPKI-06-1144/21-Arben Dodaj", sepse kemi përgjigje nga AKK.

Propozimi u miratua, me 8 (tetë) vota për dhe 1 (një) kundër.

Mimoza Kusari- Lila, tha se bazuar në nenin 65, paragrafi 1, pika d) e Rregullores së Kuvendit, propozoi që pika 4 (katër) e rendit të ditës, të jetë e mbyllur për media, për shkak të ndjeshmërisë së materialit që e kemi pranuar nga NPKOSTT Sh.A. dhe në mënyrë që diskutimet të jenë më të frytshme.

Pal Lekaj, tha se nuk shoh se kemi dokumente sensitive apo konfiendiale, që të kërkohet mbyllja e komisionit për media në këtë pikë.

Mimoza Kusari – Lila, tha se po kërkon diçka që ka bazë në Rregulloren e Kuvendit dhe ky propozim ka për qëllim që debati të jetë më i fokusuar në çështjen, për të cilën e kemi ftuar menaxhmentin dhe anëtarët e Bordit të NP "KOSTT". Për të gjitha vendimet që do të ndërmerren do të njoftohen mediat dhe të gjitha palët e interesit.

Valentina Bunjaku- – Rexhepi, tha se pasi që të gjitha vendimet mund të jenë të qasshme për media dhe palët e interesit, nuk e shoh të arsyeshme mbylljen e kësaj pike për mediat.

Pas diskutimeve, propozimi u miratua, me 6 (gjashtë) vota për dhe 2 (dy) vota kundër, për mbylljen për media të pikës së 4 (katërt) të rendit të ditës, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtura më datë 27.7.2021 dhe 4.8.2021

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më datë 27.7.2021 dhe 4.8.202, u miratuan me vota unanime nga anëtarët e Komisionit.

3. Shqyrtimi i raportit të grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shoqëritë tregtare

Kryesuesja njoftoi se grupi punues, në bazë të planit të veprimit, ka përfunduar procesin e mbikëqyrjes së këtij ligji, po ashtu raportin e kemi pranuar të gjithë anëtarët, andaj në cilësinë e kryesues së këtij grupi punues, ia dha fjalën znj. Mimoza Kusari- Lila.

Mimoza Kusari- Lila, duke e elaboruar raportin, tha se nga gjetjet e identifikuara, grupi punues vlerëson se Ministria dhe Qeveria kanë përmbushur obligimin, sa i përket kompletimit të kornizës

ligjore, përkatësisht nxjerrjes së akteve nënligjore në zbatim të ligjit. Sa i përket kuotës gjinore në shoqëritë aksionare, ka moszbatim të Ligjit për shoqëritë tregtare. Çështja e kuotës gjinore në bordet e shoqërive aksionare, ngrihet si barrierë nga bizneset, megjithatë nuk ka ndonjë statistikë apo analizë se për shkak të kuotës gjinore, ndonjë biznes ka hezituar të regjistrohet apo nuk ka vazhduar veprimtarinë. Ministria, para plotësimit dhe ndryshimit të ligjit, duhet të bëjë një analizë lidhur me zbatimin e kuotës gjinore në bordet e shoqërive aksionare, mundësitë për kuotë gjinore në llojet tjera të bizneseve, arsyet e kundërshtimit të kuotës gjinore nga bizneset, ndikimi i kuotës gjinore të bizneset, mundësitë për përkrahje të bizneseve, të cilat plotësojnë kuotën gjinore, dhe në përgjithësi, për çështjen e femrave në vendimmarrje të bizneseve. Çështja e sanksioneve, implikimeve të kuotës gjinore te bordet e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara, çështjen e të dhënave në dokumentin e regjistrimit dhe çështje tjera të ngritura gjatë aktiviteteve mbikëqyrëse, do të mund të rregullohen me rishikimin e Ligjit për shoqëritë tregtare, në të ardhmen. Për të përmirësuar këtë gjendje, nevojiten masa konkrete dhe të drejtpërdrejta nga institucionet përgjegjëse. Në fund, prezantoi rekomandimet para komisionit dhe kërkoi të miratohen, si dhe t'i përcillen seancës plenare, e cila është e caktuar të mbahet nesër, më datë 6.8.2021.

Pal Lekaj, tha se nuk pashë sa takime i keni mbajtur, a ka sugjerime nga palët e interesit, nëse ligji nuk ka ndryshuar në thelb, por vetëm ndryshime kozmetike në këtë amendamentim, atëherë nuk kemi bërë asgjë, sepse do të duhej të merrnim parasysh sugjerimet, sidomos të odave ekonomike.

Mimoza Kusari Lila, tha se për z. Lekaj, se nuk është konsultuar me material, sot nuk jemi duke bërë amendamentimin e ligjit, por kemi bërë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Faza e amendamentimit vjen më vonë. Të gjitha të gjeturat dhe takimet me palë të interesit i keni nga faqja 8 deri në faqen 13 të raportit. Pra, është bërë një punë serioze, ku e keni një raport 15 faqesh dhe dhjetëra faqe tjera bashkëngjitur për takimet, vizitat në terren, dëgjimin publik, raportimin e ministres Hajdari etj.

Pal Lekaj, tha se ligjet monitorohen për të ardhur deri te të gjeturat, të cilat nuk kanë munurd të impelmentohen dhe këto pastaj të ndryshohen. Një e gjetur ishte që nuk është zbatuar kuota gjinore.

Pas debatit, Komisioni, me 6 (gjashtë) vota për, i propozoi Kuvendit këto:

R e k o m a n d i m e

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë:

a) *Të ndryshojë dhe të plotësojë Ligjin për shoqëritë tregtare, duke adresuar: harmonizimin e ligjit me legjislacionin e BE-së; çështjet e ndërlidhura me dokumentet/formularët e regjistrimit, që kanë të bëjnë me anëtarët e bordeve e kompanive nga jashtë vendit; rregullimi i tipit të ndërmarrjeve "Holding", kooperativave bujqësore dhe ndërmarrjet sociale; çështjet e ndërlidhura me statutin e shoqërive tregtare, çështjet me qasjen në të dhënat relevante të bizneseve, në regjistrimin e llojeve të tjera të bizneseve.*
b) *Të bëjë fushatë vetëdijesuese dhe të krijojë skema për mbështetje të bizneseve, të cilat plotësojnë kuotën gjinore në borde dhe pozita të larta vendimmarrëse, si dhe mos të*

kualifikojë për grante, subvencione ose lehtësira tjera, për ato kompani që nuk e respektojnë ligjin, sa i përket detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 34, nënparagrafi 2, 5, 3 të ligjit.

c) *Të nxisë marrëveshjet ndërshtetërore, për të mundësuar bashkimet ndërkufitare të korporatave në zbatim të neneve 229-237 të ligjit.*
d) *Të zgjedhë drejtorin e ARBK-së, në një afat prej 3 (tre) muajsh, pas miratimit të këtyre rekomandimeve nga Kuvendi.*
e) *Ta krijojë platformën "Single Point of Contact", sipas Direktivës së shërbimeve të Bashkimit Evropian, e cila tashmë është e shndërruar në ligj (Ligji për shërbime).*
f) *Të shtohen përpjekjet për tejkalimin e diferencave dhe pengesave në regjistrimin e degëve/filialeve të bizneseve nga Kosova dhe Shqipëria dhe anasjelltas.*
g) *ARBK të diskutojë me komunat e vendit, për mundësinë e kalimit të zyrtarëve nëpër komuna, që të bëjnë regjistrimin/çregjistrimin e bizneseve, si zyrtarë të ministrisë, duke përfshirë edhe promovimin e mundësive investive në nivelin komunal.*
h) *ARBK të marrë masa adekuate konform ligjit kundër burokracisë, duke e thjeshtuar procedurën e çregjistrimit të bizneseve.*
i) *ARBK, në bashkëpunim me ATK-në, të hartojë një memorandum bashkëpunimi, për shfrytëzimin e raporteve vjetore që dorëzohen në ATK në formë elektronike, në mënyrë që bizneset të mos obligohen të dorëzojnë të njëjtat raporte edhe në ARBK, por t'i shfrytëzojë ato që tanimë janë dorëzuar në ATK.*
j) *Brenda 6 (gjashtë) muajve, pas miratimit të këtyre rekomandimeve nga Kuvendi, të raportojë mbi zbatimin e tyre.*

Autorizohet nënkryetarja e parë e komisionit, të bëjë amendament në rendin e ditës së seancës plenare, datë 6.8.2021, që të përfshihet ky raport në seancën e radhës.

4. Raportimi i bordit dhe menaxhmentit të NP KOSTT, lidhur me organizimin e brendshëm dhe zbatimin e projekteve

Kryesuesja, fillimisht i njoftoi palët e ftuara, bordin dhe menaxhmentin e NPKOSTT Sh.A., se kjo pikë e rendit të ditës është e mbyllur për media, mirëpo do të incizohet, por në procesverbal do të zbardhen vetëm vendimet e komisionit. Arsyeja e caktimit të kësaj pike të rendit të ditës, është se si deputetë kemi marrë informata lidhur me probleme dhe pretendime të shkeljes së ligjit nga ana e menaxhmentit dhe bordit. Andaj, jeni ftuar që të raportoni si bord dhe menaxhment i lartë i KOSTT-it.

Në mbledhje diskutuan deputetët: **Mimoza Kusari- Lila, Armend Muja, Driton Hyseni, Valentina Bunjaku** dhe **Pal Lekaj.**

Ndërkaq, nga NP "KOSTT" Sh.A. dhanë përgjigje në pyetjet e deputetëve, kryesuesi i bordit, **Jeton Mehmeti,** anëtarët e bordit **Arben Dodaj, Ajrina Gashi, Xhyldane Kiçmari** dhe **Nebih Zariqi** dhe kryeshefi ekzekutiv, **Mustafë Hasani**.

Pas debatit, komisioni, me 6 (gjashtë) vota për, nxori këto:

R e k o m a n d i m e

1. *Zyra Kombëtare e Auditimit të bëjë auditim të menjëhershëm, të të gjitha vendimeve, nga 1 janar 2015, të cilat kanë të bëjnë me dhënien e pëlqimeve për ndërtim/shfrytëzim të pronës së NP "KOSTT" Sh.A., nga palët tjera, si dhe projektet që kanë të bëjnë me investimet kapitale.*
2. *Zyra Kombëtare e Auditimit të bëjë auditim të performancës së NP "KOSTT" Sh.A., më së largu deri më 30 shtator 2021, me fokus në:*
   2.1 . Vendimet lidhur me strukturën e brendshme organizative.
   2.2. Vendimet të ALPEX, dega Kosovë.

5. Shqyrtimi i shkresave të Agjencisë Kundër Korrupsionit, lidhur me rastin AAK-DPKI-06-2773/20-Xhyldane Kiçmari dhe AKK-DPKI-06-1144/21-Arben Dodaj

Kryesuesja, tha se lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, ia dha fjalën z. Muja, pasi që ishte edhe propozues i kësaj pike.

Armend Muja, tha se në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, kam pranuar shkresën e Agjencisë Kundër Korrupsionit, lidhur me dy rastet që na janë drejtuar: AKK-DPKI-06-2773/20-Xhyldane Kiçmari dhe AKK-DPKI-06-1144/21-Arben Dodaj, të dy anëtarë të NP "KOSTT", lidhur me çështjen e konfliktit të interesit, sepse ushtrojnë dy pozita. Kështu që, bazuar në këto shkresa të AKK-së dhe në opinionin ligjor të Drejtorisë për Shërbime Juridike dhe Përafrim të Legjislacionit të Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, merr për bazë opinionet e dala, lidhur me rastet dhe nuk ka interpretim tjetër për këtë çështje. Andaj, duhet të kërkohet që të dy anëtarët e bordit të përcaktohen, se cilën pozitë do ta ushtrojnë.

Pas debatit, komisioni nxori këtë:

Përfundim

Bazuar në shkresat e Agjencisë Kundër Korrupsionit, lidhur me rastet (AKK-DPKI-06-2773/20-Xhyldane Kiçmari dhe AKK-DPKI-06-1144/21-Arben Dodaj), Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, më datë 5.8.2021, vlerësoi se nuk ka interpretim tjetër për këtë çështje, andaj kërkohet nga dy anëtarët e Bordit të NP "KOSTT", që deri më datë 6.8.2021, në orën 11:00, të deklarohen, se cilën pozitë do ta ushtrojnë.

6. Të ndryshme
Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Jeta Statovci,
Nënkryetare e parë e Komisionit